

VENDIM
Nr. 188, datë 23.11.2016

MBI KËRKESËN PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË “DENAS POWER” SHPK, NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE ALBANIA” SHA

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 20, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të neneve 2, 3 dhe 4, të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës “Për prodhimin e energjisë elektrike”, gjithashtu, dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin dhe informacionin plotësues mbi kërkesën e shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., për lënie peng asetesh në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a., të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

Në Aplikimin e shoqërisë “Denas Power” sh.p.k. kërkohet transferimi i aseteve, të cilat nuk rezultojnë të jenë asete të të licencuarit.

Ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” në nenin 44 dhe Rregullorja e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit përcaktojnë autoritetin e ERE-s për trajtimin e kërkesave për transferim të aseteve të të licencuarit si më poshtë:

- shitje, dhënie me qira, transferimi, hipotekim, barrë ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Deklarimin e mungesës së juridiksionit administrativ të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., për lënie peng të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme që do të krijojë në të ardhmen e që do të shërbejnë vetëm për veprimtarinë për të cilën është licencuar nga ERE, në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti